



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za regionalni razvoj
Ministry of Regional Development

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE



ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR, PERIUDHA 2018-2020

Tetor , 2021

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe i njëjti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, ministrive të linjës dhe komunave të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme për përkrahjetë sektorit privat në Kosovë.

DOKUMENTI U HARTUA NGA:

Vjendita Avdiu Musliu, Zv. Drejtoreshë e Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio - Ekonomike Rajonale
Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio - Ekonomik
Amill Vellija, Konsulent për Monitorimin e Zhvillimit Socio-Ekonomik të Balancuar

Mbikqyrur nga:

Besim Kamberaj - zv.Sekretari i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

Copyright. 2021 – Ministria e Zhvillimit Rajonal
Republika e Kosovës, Prishtinë 10 000
<https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>

Përmbajtja:

1. HYRJE	9
2. Implimentimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2020) nga MZHR në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë.....	11
3. Impakti i PZHRB-së nga viti 2018-2020 në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë.....	12
3.1. Vlera totale e financuar nga MZHR-ja në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë	13
3.2. Paraqitja grafike e të dhënave sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore për periudhën 2018-2020.....	14
3.3. Numri i punësuarve dhe bizneset pëfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë	15
3.4. Paraqitja grafike e të dhënave sipas pesë (5) rajone zhvillimore për periudhën 2018-2020.....	16
3.5. Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës gjatë vitin 2018-2020	19
3.6. Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë gjatë vitit 2018-2020 në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë	22
3.7. Sektorët e financuar nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për periudhën (2018-2020)	24
4. Përkrahja e sektorit privat (PZHRB) 2020, Rajoni Zhvillimor Qendër	25
4.1. Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës gjatë vitit 2020	26
4.2. Rajoni Zhvillimor Qendër dhe impakti i PZHRB-së për tre (3) vite 2018-2020	27
4.3. Paraqitja tabelare e numrit të aplikimeve, numrit të bizneseve përfituese dhe numrit të të punësuarve në Rajonin Zhvillimor Qendër gjatë v.2018-2020	34
4.4. Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas loteve për vitin 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Qendër	36
4.5. Sektorët e Rajonit Zhvillimor Qendër për periudhën (2018-2020).....	38
4.6. Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë gjatë vitit 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Qendër	38
4.7. Shpërndarja e projekteve sipas komuniteteve në Rajonin Zhvillimor Qendër gjatë vitit 2018-2020.....	39
5. Përkrahja e sektorit privat - Rajoni Zhvillimor Jug (PZHRB 2020)	41
5.1. Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës gjatë vitit 2020	41
5.2. Rajoni Zhvillimor Jug dhe impakti i PZHRB-së për vitin 2018-2020.....	42
5.3. Numri i aplikimeve, numri i bizneseve përfitues dhe numri i të punësuarve në Rajonin Zhvillimor Jug gjatë v.2018-2020	48
5.4. Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas loteve për vitin 2018-2020 në Rajonin Jug	50
5.5. Sektorët e Rajonit Zhvillimor Jug për periudhën (2018-2020)	51
5.6. Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në Rajonin Zhvillimor Jug	51
5.7. Shpërndarja e projekteve sipas komuniteteve në Rajonin Zhvillimor Jug gjatë periudhës 2018-2020	52
6. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim	54
6.1. Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës	54
6.2. Rajoni Zhvillimor Perëndim dhe impakti i PZHRB-së për vitin 2018-2020.....	55
6.3. Numri i aplikimeve, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve përfituesve në Rajonin Zhvillimor Perëndim gjatë v.2018-2020	61
6.4. Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas loteve për vitin 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Perëndim	63
6.5. Sektorët e Rajonit Zhvillimor Perëndim për periudhën (2018-2020)	65
6.7. Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Perëndim gjatë periudhës 2018-2020..	66

.....	67
7. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Veri	68
7.1. Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës	68
7.2. Rajoni Zhvillimor Veri dhe impakti i PZHR-së për vitin 2018-2020	69
7.3. Numri i aplikimeve, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve përfituesve në Rajonin Zhvillimor Veri gjatë v.2018-2020	76
7.4. Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas loteve për vitin 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Veri.....	77
7.5. Sektorët e Rajonit Zhvillimor Veri për periudhën (2018-2020)	79
7.6. Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në Rajonin Zhvillimor Veri.....	79
7.7. Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajoni Zhvillimor Veri gjatë periudhës 2018-2020	80
8. Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje	82
8.1. Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës	82
8.2. Rajoni Zhvillimor Lindje dhe impakti i PZHR-së për vitin 2018- 2020.....	83
8.3. Numri i aplikimeve, numri i të punësuarve dhe bizneset përfituese gjatë periudhës v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	92
8.4. Shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas loteve për vitin 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	94
8.5. Sektorët e Rajonit Zhvillimor Lindje për periudhën (2018-2020)	95
8.6. Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në Rajonin Zhvillimor Lindje.....	96
8.7. Shpërndarja e projektve sipas komuniteteve në Rajonin Zhvillimor Lindje gjatë vitin 2018-2020.....	96
9. Skema e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2020“ Masa 8 (Lot I dhe Lot II).....	98
9.1. Synimet e Thirrjes për Propozime	98
9.2. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues (MZHR)	98
9.3. Bizneset përfituese dhe numri i aplikuesve në “Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2020“ Masa 8.....	99
10. Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019-2020 nga MTI	102
10.1. Paraqitja grafike e të dhënave nga programi Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2019 dhe 2020 nga MTI për tre kategoritë e ndërmarrjeve.	105
11. Programi për përkrahjen e bizneseve fillestare në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë nga MIN për v.2019	106
12. Përfundime.....	108
13. BURIMET E INFORMACIONIT	110

Figura 1: Shpërndarja e mjeteve sipas PZHRB për tre (3) vite 2018-2020 në pesë (5) rajone zhvillimore sipas strukturës etnike	14
Figura 2 Vlera totale e financimit sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020) në pesë rajone zhvillimore.....	14
Figura 3: Vlera totale e financuar nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020).....	15
Figura 4: Nr. i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020).....	17
Figura 5: Nr. i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020).....	17
Figura 6: Nr. i bizneseve përfituese sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020) vite në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë	17
Figura 7: Nr. i bizneseve përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020).	18
Figura 8: Numri total i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020)	18
Figura 9: Numri total i bizneseve përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020).....	18
Figura 10: Shpërndarja e nr. të projekteve sipas përkatësisë etnike në tre (3) vite (2018,2019 dhe 2020) në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës	21
Figura 11: Shpërndarja e nr. të projekteve sipas përkatësisë etnike në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës gjatë tre (3) viteve 2018-2020.....	21
Figura 12: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020).....	21
Figura 13: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020).....	22
Figura 14: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020).....	22
Figura 15: Paraqitja grafike e projekteve të udhëhequra nga gratë për tre(3) vite (2018-2020).....	23
Figura 16: Paraqitja grafike e projekteve të udhëhequra nga gratë për tre (3) vite (2018-2020).....	24
Figura 17: Shpërndarja totale në përqindje % e projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore .	24
Figura 18: Paraqitja grafike e sektorëve në pesë (5) rajone zhvillimore për tre (3) vite (2018-2020).....	25
Figura 19: Përqindja e aplikimeve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Qendër.....	35
Figura 20: Përqindja e të punësuarve në Rajonin Zhvillimor Qendër gjatë v.2018-2020	35
Figura 21: Përqindja e bizneseve përfituese në Rajonin Zhvillimor Qendër gjatë v.2018-2020	35
Figura 22: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot1) për periudhën (2018-2020)	37
Figura 23: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot2) për periudhës (2018-2020).....	37
Figura 24: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot3) për periudhën (2018-2020)	37
Figura 25 Shpërndarja e projektve të udhëhequr nga gratë gjatë v.2018-2020	39
Figura 26: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike v,2018 ,2019 dhe 2020	40
Figura 27: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike v,2018 ,2019 dhe 2020	40
Figura 28: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike v,2018 ,2019 dhe 2020	40
Figura 29: Përqindja e aplikimeve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Jug	48
Figura 30: Përqindja e të punësuarve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Jug	49
Figura 31: Përqindja e bizneseve përfituese gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Jug	49
Figura 32: Përqindja e shpërndarjes e mjeteve sipas (Lot1)	50
Figura 33: Përqindja e shpërndarjes e mjeteve sipas (Lot2)	50
Figura 34: Përqindja e shpërndarjes e mjeteve sipas (Lot3)	51
Figura 35: Shpërndarja e projektve të udhëhequr nga gratë gjatë v.2018-2020	52
Figura 36: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike v,2018	53
Figura 37: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike v, 2019	53
Figura 38: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike v, 2020	53
Figura 39: Përqindja e aplikimeve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Perëndim	62
Figura 40: Përqindja e të punësuarve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Perëndim	62
Figura 41: Përqindja e bizneseve përfituese gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Perëndim	62
Figura 42: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot1) në RZHP	64
Figura 43: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot2) në RZHP	64
Figura 44: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot3) në RZHP	64
Figura 45: Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në RZHP	66
Figura 46: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike në RZHP gjatëv.2018-2020	67
Figura 47: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike në RZHP gjatëv.2018-2020	67
Figura 48: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike në RZHP gjatëv.2018-2020	67
Figura 49: Përqindja e aplikimeve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Veri.....	76
Figura 50: Përqindja e i të punësuarve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Veri.....	76
Figura 51: Numri i bizneseve përfituese gjatë 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Veri.....	77
Figura 52: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot 1).....	78

Figura 53 Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot2)	78
Figura 54: Përqindja e shpërndarjes së mjeteve sipas (Lot3)	78
Figura 55: Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në Rajonin Zhvillimor Veri.....	80
Figura 56: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike për v.(2018)	81
Figura 57: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike për v.(2019)	81
Figura 58: Përqindja e shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike për v.(2020)	81
Figura 59: Përqindja e i aplikimeve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	92
Figura 60: Përqindja e të punësuarve gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	93
Figura 61: Përqindja e bizneseve përfituese gjatë v.2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	93
Figura 62: Shpërndarja mjeteve sipas (Lot 1)	94
Figura 63: Shpërndarja mjeteve sipas (,Lot2)	94
Figura 64: Shpërndarja mjeteve sipas (Lot3)	95
Figura 65: Shpërndarja e projekteve gjatë v.2018-2020 të udhëhequra nga gratë në RZHL	96
Figura 66: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike, sipas V.2018.....	97
Figura 67: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike, V.2019	97
Figura 68: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike, sipas v. 2020	97
Figura 69: Bizneset përfituese sipas rajoneve zhvillimore Masa 8 v.2020.....	100
Figura 70: Bizneset përfituese sipas rajoneve zhvillimore Masa 8 v.2020.....	101
Figura 71: Programi për përkrahjen e NMV-ve sipas kategorive të ndërmarrjeve mikro (1-9)punëtor	105
Figura 72: Programi për përkrahjen e NMV-ve sipas kategorive të ndërmarrjeve të vogla (10 -i 49) punëtor	105
Figura 73: Programi për përkrahjen e NMV-ve sipas kategorive të ndërmarrjeve të mesme (50-249) punëtor	105

Tabela 1: Vlera totale e financuar nga MZHR-ja, PZHRB (2018-2020)	13
Tabela 2: Numri i të punësuarve dhe bizneset përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë.....	15
Tabela 3: Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas përkatësisë etnike në pesë(5) rajone zhvillimore	19
Tabela 4: Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve të udhëhequra nga gratë për tre vite vite (2018 -2020).....	23
Tabela 5: Paraqitja tabelare e nr. të bizneseve përfituese sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve	25
Tabela 6: Paraqitja tabelare e të dhënave për tre (3) vite në RZHQ (2018,2019 dhe 2020)	28
Tabela 7: Paraqitja e përgjithëshme e investimeve për Rajonin Zhvillimor Qendër (Lot1, Lot2, Lot3):	34
Tabela 8: Numri i të punësuarve dhe bizneset përfituese në RZHQ v.2018-2020.....	34
Tabela 9: Komunitat e RZHQ, PZHRB (2018-2020)	36
Tabela 10: Paraqitja e pesë (5) sektorëve më të financuar në RZHQ për periudhën (2018-2020)	38
Tabela 11: Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë RZHQ.....	39
Tabela 12: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Qendër gjatë v. 2018-2020.....	39
Tabela 13: Paraqitja tabelare e të dhënave për tre (3) vite në RZHQ (2018, 2019, 2020).....	43
Tabela 14: Paraqitja e përgjithëshme e investimeve në Rajonin Zhvillimor Jug (Lot1,Lot2,Lot3)	47
Tabela 15: Numri i aplikimeve, numri i punësuarve dhe bizneset përfituese Rajonin Jug gjatë v.2018-2020.....	48
Tabela 16: Paraqitja tabelare e Komunitatave të RZHQ, sipas nr. të aplikimeve, bizneseve përfituese dhe të punësuarve për tre(3) vite (2018-2020)	49
Tabela 17: Paraqitja e pesë (5) sektorëve më të financuar në RZHQ për periudhën (2018-2020)	51
Tabela 18: Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë gjatë v.2018-2020 në RZHL.....	52
Tabela 19: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Jug gjatë v. 2018-2020	52
Tabela 20: Paraqitja e të gjitha të dhënave për tre (3) vite në RZHP (2018,2019, 2020)	56
Tabela 21: Paraqitja e përgjithëshme e investimeve për Rajonin Zhvillimor Perëndim (Lot1, Lot2, Lot3)	60
Tabela 22: Numri i të punësuarve dhe bizneset përfituesve në Rajonin Zhvillimor Perëndim gjatë v.2018-2020	61
Tabela 23: Paraqitja tabelare e Komunitatave të RZHP, sipas nr. të aplikimeve, bizneseve përfituese dhe të punësuarve për tre (3) vite (2018-2020)	63
Tabela 24: Paraqitja e pesë (5) sektorëve më të financuar në RZHP për periudhën (2018-2020).....	65
Tabela 25: Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë gjatë v. 2018-2020.....	65
Tabela 26: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Perëndim gjatë v. 2018-2020	66
Tabela 27: Paraqitja tabelare e të dhënave për tre (3) vite në RZHV (PZHRB 2018, 2019 dhe 2020)	70
Tabela 28: Paraqitja e investimeve për Rajonin Zhvillimor Veri (Lot1, Lot2, Lot3):.....	75
Tabela 29: Numri i të punësuarve dhe bizneset përfituesve në Rajonin Zhvillimor Veri gjatë v.2018-2020.....	76
Tabela 30: Paraqitja tabelare e Komunitatave të RZHV sipas nr. të aplikimeve, bizneseve përfituese dhe të punësuarve për tre(3) vite (2018-2020)	77
Tabela 31: Paraqitja e pesë(5) sektorëve më të financuar në RZHV për periudhën (2018-2020).....	79
Tabela 32: Shpërndarja e projekteve gjatë vitin 2018-2020 të udhëhequra nga gratë në Rajonin Zhvillimor Veri.....	79
Tabela 33: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Veri gjatë vitin 2018-2020.....	80
Tabela 34: Paraqitja e të gjitha të dhënave në RZHL (PZHRB 2018-2020) për tre (3) vite (2018,2019,2020)	84
Tabela 35: Paraqitja e përgjithëshme e investimeve për Rajonin Zhvillimor Lindje (Lot1, Lot2, Lot3):	91
Tabela 36 Numri i aplikimeve, numri punësuarve dhe bizneset përfituese gjatë vitin 2018-2020 në Rajonin Zhvillimor Lindje	92
Tabela 37: Paraqitja tabelare e Komunitatave të RZHL, sipas nr. të aplikimeve, bizneseve përfituese dhe të punësuarve për tre(3) vite (2018-2020)	93
Tabela 38: Paraqitja e pesë(5) sektorëve më të financuar në RZHL për periudhën (2018-2020)	95
Tabela 39: Shpërndarja e projekteve gjatë v.2018-2020 të udhëhequra nga gratë në RZHL.....	96
Tabela 40: Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në Rajonin Zhvillimor Lindje gjatë periudhës 2018-2020	96
Tabela 41: Nr.i aplikuesve dhe nr. i përfituesve të bizneseve Masa 8 për v.2020	99
Tabela 42: Bizneset përfituese sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore Masa 8 v.2020	100
Tabela 43: Bizneset përfituese sipas Rajoneve Zhvillimore Masa 8 v.2020 të udhëhequra nga gratë.....	101
Tabela 44: Përfituesit e granteve për biznese për vitet v.2019 dhe 2020 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.....	102
Tabela 45: Përfituesit e NMV-ve nga MIN.....	106

Lista e shkurtesave:

Shkurtesat e përdorura në këtë analizë janë si vijon:

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MTI	Ministria e Teknologjise Informative
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar
PZHR	Programi për Zhvillim Rajonal
AZHR	Agjencia e Zhvillimit Rajonal
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
RZHK	Rajonet Zhvillimore të Kosovës
AZHRP	Agjencia për Zhvillimi Rajonal Perëndim
AZHRJ	Agjencia për Zhvillimi Rajonal Jug
AZHRL	Agjencia për Zhvillimi Rajonal Lindje
AZHRV	Agjencia për Zhvillimi Rajonal Veri
AZHRQ	Agjencia për Zhvillimi Rajonal Qendër

1. HYRJE

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me shtojcën 15 të Rregullores (QKR) Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e Punës për vitin 2021, ka përgatitur “Analizën për zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë për tre (3) vite 2018, 2019 dhe 2020.

MZHR si rrjedhojë e mandatit të saj zhvillon dhe menaxhon programe për të ofruar zhvillim socio – ekonomik rajonal të balancuar në pesë (5) rajone zhvillimore të Kosovës, si dhe bënë promovimin e tyre. Kjo analizë, hyn edhe në kuadër të kompetencës së MZHR-së për përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar”. Në këtë analizë krahasuese, trajtohet përkrahja e MZHR-së dhe ministrive të linjës ndaj sektorit privat – bizneseve e realizuar gjatë tre (3) viteve 2018 -2020. Analiza e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar, këtë vit do të pasqyrojë të dhënat krahasimore për tre vite të implementimit të këtij programi nga MZHR, mbështetjen që i është dhënë sektorit privat në kuadër të kësaj skeme si dhe ndikimit që ka pasë kjo skemë në qëndrueshmërinë e funksionimit të sektorit privat. MZHR me lansimin e grant skemës për financimin e sektorit privat ndihmon bizneset që të plotësojnë nevojat e tyre të të bërit biznes. Gjithashtu përmes publikimit të kësaj analize MZHR synon të stimulojë zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar ndërmjet pesë (5) rajoneve zhvillimore: Qendër, Veri, Perëndim, Lindje dhe Jug. Analiza pasqyron subvencionimin e bizneseve duke paraqitur zgjerimin e kapaciteteve të tyre pas pranimit të përkrahjes nga shteti, rritjen e qarkullimit, shtimin e kapaciteteve prodhuese dhe njerezore, zvogëlimin e importit dhe nxitjen e exportit.

Kjo analizë gjithashtu trajton programet- skemat për dhënien e granteve të implementuara edhe nga Ministritë e linjës, si të dhënat krahasimore të vitit 2020 dhe vitit 2019 të skemës së granteve për përkrahje të ndërmarrejeve të vogla dhe të mesme (NMV-ve), program i implementuar edhe Agjencia për Investime dhe përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe përkrahjen e sektorit privat nga Ministria e Inovacionit për v.2019.

Si pasojë e efekteve negative që janë krijuar tek sektori privat nga pandemia Covid 19, MZHR ka implementuar programin për rimëkëmbje ekonomike, Pre Masa 8 për vitin 2020. Programi për Rimëkëmbje Ekonomike, ka derivuar nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, i aprovuar në Qeveri më 05.06.2020 me nr.01/02, dhe ka pasë për qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit. Ministria e Zhvillimit Rajonal është angazhuar për të kontribuar në këtë pako dhe ka planifikuar të jetë pjesë e Masës 8 të aprovuar me vendimin e qeverisë Nr.01/23 datë 13.08.2020.

Për dallim nga analizat e dy (2) viteve të kaluara të publikuara nga MZHR të vitit 2018 dhe vitit 2019, këtë vit në dokument janë përfshirë të dhënat krahasimore për tre vite si: shumat totale të subvencionimit, numri i aplikimeve dhe përfituesve sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave, sektorët përfitues dhe krahasueshmeria e tyre ndërmjet pesë (5) rajoneve zhvillimore të Kosovës, krijimi i vendeve të reja të punës, shpërndarja e mjeteve financiare në % sipas lotëve, shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike të përfituesve, si dhe shpërndarja e projekteve të përfituesve në bazë të gjinisë.

Për tre (3) vite 2018 - 2020, Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ,PZHRB (2018,2019 dhe 2020) ka arritur të krijojë 1751 vende të reja të punës, si dhe janë përkrahur 496 projekte në total duke mos përfshirë numrin e projekteve të mbështetura në kuadër të Skemes Masa 8, që rezulton me 167 projekte shtesë të financuara në (Lot1 dhe Lot 2). Përmes këtij programi, MZHR në koordinim me partnerët ndërkombëtar ka arrit të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjate të funksionimit të bizneseve. Në bashkëpunim me BERZH janë realizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së bizneseve egzistuese ,ku posaçërisht është punuar me Start- UP në funksion të zhvillimit dhe përkrahjes së tyre si biznese fillestare. Nga v.2018 në v. 2019 , MZHR ka avancuar Udhëzuesin për aplikant sipas kategorive të Loteve në vlerat e qarkullimit. Në kuadër të PZHRB-së janë bërë lehtësime në procedurat administrative të implimentimit të projektit.

MZHR rregullisht përgjatë tre viteve ka realizuar sesione informuese për bizneset sa i përket aplikimit online në SMAED dhe tash në sistemin elektronik E-kosova si dhe sesione informuese për implementim të projekteve. Këto sesione janë organizuar vazhdimisht në koordinim me AZHR-të në pesë rajone zhvillimore me të cilat operon MZHR si dhe së fundmi në kuadër të bashkëpunimit me BERZH.Në kuadër të këtij bashkëpunimi sesionet informuese gjatë v.2020 janë realizuar online si pasojë e masave mbrojtëse kundrejt COVID 19. Gjithashtu kjo skemë vazhdimisht ka stimuluar projektet inovative tek gratë dhe tek të rinjtë si dhe ka stimuluar komunitetet pakicë të aplikojnë sa më shumë në kuadër të kësaj skeme. Sektori i prodhimit është stimuluar vazhdimisht në PZHRB 2018-2020.

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për të pasqyruar në mënyrë sa më transparente dhe direkte impaktin që ka pas skema e granteve"Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar "(PZHRB) specifikisht ka realizuar një pyetësor me pyetje specifike, i cili është shpërndarë tek një mostër prej rreth dyqind (200) përfituesëve të viteve 2018 dhe 2019. MZHR ka pranuar mbi njëqind (100) pyetësor më përgjigje brenda afatit të përcaktuar zyrtarisht. Pyetësori në përgjithësi në përmbajtjen e tij ka përmbledhur të dhëna të përgjithëshme si: viti i përfitimit të biznesit, komunat përfituese, përfituesit sipas përkatësisë etnike, veprimtaria e biznesit duke u thelluar në pyetje specifike që lidhen direkt me qëllimin dhe objektivat që kjo skemë përmbushë përmes financimit të sektorit privat. Gjitha përgjegjet janë analizuar dhe paraqitur edhe në formë grafike përmes përqindjeve dhe vlerave numerike ku si rezultat i rekomandimeve, MZHR është përkushtuar që maksimalisht të avansoj si nga aspekti teknik poashtu edhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve humane, në mënyrë që ky program të avancohet cdo herë e më shumë dhe qëllimi i tij të arrihet të bëhet i qartë në nivel sa më transparent, më profesional dhe sa më afër nevojave të biznesve. Në këtë kontekst, gjithashtu MZHR ka rrit përkushtimin rreth krijimit të mundësive të reja me donatorë vendor dhe ndërkombëtar,të ngritjes së kapaciteteve për aplikim dhe implementim të projektve si dhe bashkëpunimet e reja me: (BERZH, UNICEF, GIZZ, USAID, CARITAS, etj. Përfituesit e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal kanë arrit të jenë përfitues të Skemes së praktikantëve të implementuar nga UNICEF.

Pyetësori ka gjeneruar rekomandime rreth avancimit të pakos së dokumentave për aplikim, periudhës së monitorimit të afateve dhe procedurave, qëndrueshmërisë së vendeve të reja të punës që janë krijuar nga kjo Skemë për periudhën 2018 dhe 2019,ndikimit në rritjen e eksportit , rritjen e qarkullimit, rritjen e nr. të klientëve dhe konkurrencës në treg, zgjerimin e kapaciteteve prodhuese , stimulimin e sektorëve specifik, etj.

Gjithashtu në kuadër të këtij pyetësori sipas përgjegjeve të pranuar nga 100 përfituesit e viteve 2018 dhe 2019, ka rezultuar që MZHR përmes PZHRB ka ndikuar me një përqindje prej 43.7% të ketë ndikim mesatar në rritjen e eksportit dhe zvogëlimin e importit tek bizneset

përfituese synim strategjik i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, me qëllim të reduktimit sa më të madh të pabarazive ekonomike, dhe zhvillimit ekonomik të balancuar në tërë territorin e Kosovës.

2. Implimentimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2020) nga MZHR në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2020, është lansuar me datë 06.05.2020 përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së granteve për biznese, e shpërndarë në lote. Për dallim nga viti 2018 ku është aplikuar manualisht, nga v. 2019 është kaluar në sistemin elektronik të aplikimit SMAED ku përfituesit kanë vijuar të aplikojnë online. Platforma online e aplikimit ju ka mundësuar aplikuesve qasje tjetër në procedurën e aplikimit, duke ndikuar në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë të aplikuesit kundrejt Institucionit. Synimi kryesor i skemës së granteve për sektorin privat është të mundësojë që projektet cilësore afariste të implementohen e zhvillohen më tej, duke krijuar vende të reja të punës, e të cilat do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që janë të alokuara në sektorët që kanë potencial më të madhë për rritje. Kjo skemë gjithashtu është fokusuar edhe në nënsektorë në kuadër të sektorit ekzistues.



Përkufizimi i lotëve dhe mjetet e dedikuara për secilin Lot për vitin 2020 , ka qenë si vijon:

- **Loti 1 – Start-up**
Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
- **Loti 1 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla**
Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
- **Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla**
Nga 5,001.00 € deri në 15,000.00 €;
- **Loti 3 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla**
Nga 15,001.00 € - 30,000.00 €.

Skema e granteve bazuar në “Programin Zhvillimor Rajonal të balancuar” gjatë vitit 2020 ka mbështetur në total numrin prej 150 projekteve të cilat janë shpërndarë si mëposht:

- Në Rajonin Zhvillimor Qendër (Komuna e Prishtinës me komunat për rreth), janë përkrahur 31 projekte;
- Në Rajonin Zhvillimor Lindje (Komuna e Gjilanit me komunat për rreth), janë përkrahur 25 projekte;

- Në Rajonin Zhvillimor Perëndim (Komuna e Pejës me komunat për rreth), janë 31 projekte;
- Në Rajonin Zhvillimor Veri (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunat për rreth), 32 janë përkrahur projekte;
- Në Rajonin Zhvillimor Jug (Komuna e Prizrenit me komunat për rreth, 31 projekte .

Në kuadër të Skemës së PZHRB (2020) gjeni mëposht të ndara në Lote aplikacionet që MZHR ka pranuar në pesë (5) rajonet zhvillimore me të cilat operon. Në total janë pranuar 2110 aplikacione apo në:

- Në L1 janë pranuar 1165 aplikacione
- Në L2 janë pranuar 249 aplikacione
- Në L3 janë pranuar 696 aplikacione

Sa i përket numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës në kuadër të PZHRB (2020) , në vitin 2020 janë të punësuar 439 persona ku nga ata në:

- Rajonin Zhvillimor Qendër - 92 persona
- Rajonin Zhvillimor Lindje - 65 persona
- Rajonin Zhvillimor Perëndim - 94 persona
- Rajonin Zhvillimor Veri - 92 persona
- Rajonin Zhvillimor Jug - 96 persona.

3. Impakti i PZHRB-së nga viti 2018-2020 në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë

Nga të dhënat e tabelës nr.1 dhe figurës nr.1 shihet se Ministria e Zhvillimit Rajonal për tre (3) vite (2018 - 2020) përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur sektorin privat në vlerë totale prej 5,631.089.30 €, duke ia shtuar kësaj vlere shumë prej 2 (dy)milion financim në kuadër të Pre Mases 8, programi për rimëkëmbje ekonomike. Nga shuma totale e financimit nga PZHRB për tre(3) vite (2018-2020) , pesë(5) rajonet zhvillimore kanë përfituar në vlerat si mëposht:

- Rajoni Zhvillimor Qendër - 1,212,134.21€
- Rajoni Zhvillimor Jug - 1,183,081.28 €
- Rajoni Zhvillimor Perëndim - 1,147,526.55 €
- Rajoni Zhvillimor Veri - 1,033,243.59 €
- Rajoni Zhvillimor Lindje - 1,055,102.87€

Nëse krahasojmë ndër vite financimin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në pesë (5) rajonet me të cilat operon kjo Ministri, shohim një shpërndarje mjaft të balancuar të financimit me diferenca të vogla të përqindjes nga rajoni në rajon varësisht nr.të aplikantëve referent për secilin rajon zhvillimor. MZHR çdo vit ka rrit vlerën e financimit dhe numrin e përfituesve në kuadër të kësaj skeme si rrjedhojë e rritjes së nr.të aplikuesve nga secili rajon zhvillimor. Viti 2020 në kuadër të PZHRB (2020) në tab.1 figuron me vlerë të financimit më të vogël në krahasim me vitet tjera ,sepse MZHR ka implementuar programet e pakos së rimëkëmbjes në vlerë prej 2 milion euro, ku kjo skemë është aplikuar në kuadër të Mases 8 dhe janë mbështetur bizneset e atakuara nga kriza ekonomike e mbylljes si pasojë e pendemisë Covid 19. Rajoni i cili më së shumti ka përfituar gjatë tre (3) viteve është Rajoni Zhvillimor Qendër dhe është pranuar nr. më i madh i aplikimeve çdoherë, meqenëse në këtë rajon gjendet kryeqyteti Prishtina dhe është i koncentruar numri më i madh i bizneseve me komunat

përbërëse të këtij rajoni.

3.1. Vlera totale e financuar nga MZHR-ja në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë

Tabela 1: Vlera totale e financuar nga MZHR-ja, PZHRB (2018-2020)

PESË (5) RAJONET ZHVILLIMORE	VITI	VLERA E FINANCIMIT-PZHRB (2018-2020) €
Rajoni Zhvillimor Qendër	2018	277,211.00 €
	2019	518,406.21 €
	2020	416,517.00 €
Total RZHQ	2018-2020	1,212,134.21€
Rajoni Zhvillimor Jug	2018	304,349.20 €
	2019	475,781.08 €
	2020	402,951.00 €
Total RZHJ	2018-2020	1,183,081.28 €
Rajoni Zhvillimor Perëndim	2018	303,163.50 €
	2019	460,775.05 €
	2020	383,588.00 €
Total RZHP	2018-2020	1,147,526.55 €
Rajoni Zhvillimor Veri	2018	208,112.50 €
	2019	449,517.24 €
	2020	375,613.85 €
Total RZHV	2018-2020	1,033,243.59 €
Rajoni Zhvillimor Lindje	2018	253,969.00 €
	2019	483,289.87 €
	2020	317,844.00€
Total RZHL	2018-2020	1,055,102.87€
GJITHËSEJ:	2018	1,346,806.00 €
	2019	2,387,769.45 €
	2020	1,896,513.85 €

3.2. Paraqitja grafike e të dhënave sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore për periudhën 2018-2020

Figura 1: Shpërndarja e mjeteve sipas PZHRB për tre (3) vite 2018-2020 në pesë (5) rajone zhvillimore sipas strukturës etnike




Figura 2 Vlera totale e financimit sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020) në pesë rajone zhvillimore





Figura 3: Vlera totale e financuar nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020)



3.3. Numri i punësuarve dhe bizneset përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për tre vite (2018-2020) ka arrit të përmbush mjaft mirë mandatin dhe objektiven e rritjes së punësimit tek të rinjët dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Për tre (3) vite 2018- 2020 në kuadër të PZHRB janë punësuar në total 1751 persona të gjithë të dëshmuar në ATK. Bizneset përfituese për tre (3) vite në kuadër të PZHRB përkojnë me totalin prej 496 biznese përfituese në pesë rajone zhvillimore. Duke përfshirë numrin e 167 bizneseve tjera shtesë në kuadër të Mases 8, totali arrin në 663 biznese gjithësejt të mbështetura nga MZHR .

Në figurat e mëposhtme gjithashtu gjeni edhe në % vlerat e bizneseve përfituese dhe të punësuarve në total për pesë rajone zhvillimore, ndërsa në tab.nr 2 mund të gjeni të detajuar sipas rajoneve zhvillimore vlerat numerike të të punësuarve dhe bizneset përfituese për secilin vit. Përmes ndihmës nga MZHR bizneseve ju është mundësuar zgjerimi dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese, zhvillimi i nën sektorëve të rinjë, rritja e eksportit, ngritja e kapaciteteve humave dhe avancim profesional i tyre përmes trajnimeve të specializuara në shfrytëzimin e makinerive si dhe zhvillimin e aftësive tjera profesionale.

Ministria e Zhvillimit Rajonal ka arrit që përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me donatorë si: CARITAS ,BERZH, GIZ, UNICEF, USAID, Odat e ndryshme të bizneseve si (Oda Kosovaro-Turke dhe Oda Ekonomike e Kosovës), të motivoj dhe mbështes bizneset në fuqizimin e tyre dhe qëndrueshmërinë në projekte duke identifikuar nevojat dhe sfidat e bizneseve dhe duke ngrit kapacitet humane, prodhuese dhe profesionale.

Tabela 2: Numri i të punësuarve dhe bizneset përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë

PEŠË (5) RAJONET ZHVILLIMORE	VITI	Numri i të punësuarve (2018-2020)	Bizneset Përfituse (2018-2020)
Rajoni Zhvillimor Qendër	2018	177	30
	2019	164	43
	2020	92	31
Total RZHQ	2018-2020	433	104
Rajoni Zhvillimor Jug	2018	96	31
	2019	177	39
	2020	96	31
Total RZHJ	2018-2020	369	101
Rajoni Zhvillimor Perëndim	2018	100	31
	2019	149	40
	2020	94	31
Total RZHP	2018-2020	343	102
Rajoni Zhvillimor Veri	2018	87	24
	2019	108	37
	2020	93	32
Total RZHV	2018-2020	288	93
Rajoni Zhvillimor Lindje	2018	101	29
	2019	152	42
	2020	65	25
Total RZHL	2018-2020	318	96
GJITHËSEJ:	2018	561	145
	2019	751	201
	2020	439	150

3.4. Paraqitja grafike e të dhënave sipas pesë (5) rajone zhvillimore për periudhën 2018-2020

Figura 4: Nr. i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020)




Figura 5: Nr. i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020)




Figura 6: Nr. i bizneseve përfituese sipas viteve (2018, 2019 dhe 2020) vite në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë




Figura 7: Nr. i bizneseve përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020)




Figura 8: Numri total i të punësuarve nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020)




Figura 9: Numri total i bizneseve përfituese nga MZHR-ja në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë për tre vite (2018-2020)

Bizneset përfituese në pesë(5) rajonet zhvillimore në Kosovë për periudhen 2018-2020



3.5. Shpërndarja e projekteve sipas përkatësisë etnike në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës gjatë vitin 2018-2020

Në tabelen e mëposhtme në formë numerike dhe grafike, MZHR ka paraqitur të detajuar ndër vite shpërndarjen e projekteve përfituese sipas përkatësisë etnike. Nëse krahasojmë ndër vite komuniteti shumicë shqiptar ka përfituar nr. më të madh të projekteve për tre (3) vite (2018-2020) nr. prej (418) përfitues, duke vijuar me komunitetin serb me një numër të përfituesëve prej (31), komuniteti boshnjak me (21) përfitues, komuniteti turk me (13) përfitues, komuniteti ashkali, rom dhe egjiptas (13) përfitues, ndërsa komuniteti me më së paku përfitues për tre (3) vite është komuniteti goran me dy (2) përfitues në total. Nga tabela mund të shohim të detajuar sipas rajoneve zhvillimore nr. e përfituesve të komuniteteve të ndryshme sipas viteve ku mund të vërehet që kemi vite ku nuk kemi pasë asnjë përfitues nga komuniteti relevant në tabele si pasojë e nr. shumë të vogël të aplikimit nga disa komunitete dhe jo ekspertizës së mjaftueshme dhe njohuri për të aplikuar në formë elektronike. Nëse shohim figurat e përqindjeve ndër vite dallojnë 2% - 6% diferencë nga viti në vit të nr. i përfituesve të komuniteteve në fjalë.

Duhet të theksohet se MZHR ka qenë e përkushtuar duke realizuar rregullisht sesione informuese përmes Agjensionëve për Zhvillim Rajonal në pesë (5) rajone zhvillimore si dhe bashkpuntorëve si BERZH, ku përfituesit janë informuar për procedura të aplikimit, kriteret që duhet të përmbushin për secilin Lot sipas Udhëzuesit për Aplikant si dhe informata tjera relevante për të arrit të një aplikim i suksesshëm. Gjithsesi MZHR duhet të mbetet edhe më tej e përkushtuar të stimuloj projektet e komuniteteve të ndryshme për të aplikuar si dhe të ngrisë kapacitetet e nevojshme për të arrit suksesshëm dhe lehtësisht aplikimin online sipas kriterëve të Udhëzuesit për Aplikant.

Në figurat e mëposhtme shohim se nga totali i përgjithshëm për tre (3) vite mesatarisht me diferenca të përqindjeve jo të mëdha 13% -19 % ka qenë përqindja e shpërndarë e projekteve në komunitete tjera.

Tabela 3: Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas përkatësisë etnike në pesë(5) rajone zhvillimore

Pesë (5) rajonet zhvillimore	Shpërndaraja e projekteve sipas përkatësisë etnike						
	Viti	Kosovar	Serb	Boshnjak	Turk	Goran	Rom, Ashakli, Egjiptas
QENDËR	2018	26	3	1	0	0	0
	2019	41	2	0	0	0	0
	2020	31	0	0	0	0	0
Total RZHQ	2018-2020	98	5	1	0	0	0
JUG	2018	20	0	8	2	1	0
	2019	26	0	11	1	1	0
	2020	21	0	0	10	0	0
Total RZHJ	2018-2020	67	0	19	13	2	0
LINDJE	2018	27	2	0	0	0	0
	2019	37	5	0	0	0	0
	2020	23	2	0	0	0	0
Total RZHL	2018-2020	87	9	0	0	0	0
PERËNDIM	2018	26	0	0	0	0	5
	2019	33	0	1	0	0	6
	2020	29	0	0	0	0	2
Total RZHP	2018-2020	88	0	1	0	0	13
VERI	2018	19	5	0	0	0	0
	2019	30	6	1	0	0	0
	2020	26	6	0	0	0	0
Total RZHV	2018-2020	75	17	1	0	0	0
TOTALI	2018	118	10	9	2	1	5
	2019	167	13	13	1	1	6
	2020	133	8	0	10	0	2

Figura 10: Shpërndarja e nr. të projekteve sipas përkatësisë etnike në tre (3) vite (2018,2019 dhe 2020) në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës




Figura 11: Shpërndarja e nr. të projekteve sipas përkatësisë etnike në 5 (pesë) Rajone Zhvillimore të Kosovës gjatë tre (3) viteve 2018-2020




Figura 12: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020)




Figura 13: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020)



Figura 14: Shpërndarja e projekteve sipas Përkatësisë etnike në përqindje % sipas viteve (2018-2020)



3.6. Shpërndarja e projekteve të udhëhequra nga gratë gjatë vitit 2018-2020 në pesë (5) Rajone Zhvillimore në Kosovë

Për tre (3) vite 2018-2020, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka mbështetur në total (141) projekte të udhëhequra nga gratë.Nr. më i madh i projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë ka qenë nga RZHQ me një nr. prej (39) përfitueseve gra, duke viju me RZHV me (32) projekte, RZHP me (26) projekte, RZHJ me (23) projekte dhe i fundit me nr. më të vogël mbetet RZHL me (21) projekte të udhëhequra nga gratë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes kësaj Skeme mbetet e përkushtuar të mbështesë edhe më fuqishëm projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë,të fuqizoj gratë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitetet e tyre profesionale, menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate të biznesit.

Në tabelen nr.4 gjeni të detajuar nr. e projekteve përfituese të grave në periudhën prej (3) viteve të implementimit të skemës së mbështetjes së sektorit privat në rajonet zhvillimore.

Rajoni Zhvillimor Qendër ka përqindjen më të lartë të përfitueseve gra për tre vite prej 29% të projekteve përfituese, si rrjedhojë e nr. më të madh të aplikimeve dhe interesimit nga ky rajon. Gjithashtu duhet të theksohet që ky rezultat në RZHQ ka ardhë si rrjedhojë e koncentrimit më të madh të bizneseve është në Rajonin Zhvillimor Qendër si dhe përshkak të kryeqytetit Prishtinës.

Tabela 4: Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve të udhëhequra nga gratë për tre vite vite (2018 -2020).

PESË (5) RAJONET ZHVILLIMORE	Viti	NUMRI I PËRGJITHËSHËM I PROJEKTEVE
Rajoni Zhvillimor Qendër	2018	11
	2019	16
	2020	12
RZHQ	2018-2020	39
Rajoni Zhvillimor Jug	2018	6
	2019	12
	2020	5
RZHJ	2018-2020	23
Rajoni Zhvillimor Perëndim	2018	12
	2019	6
	2020	8
RZHP	2018-2020	26
Rajoni Zhvillimor Veri	2018	13
	2019	11
	2020	8
RZHV	2018-2020	32
Rajoni Zhvillimor Lindje	2018	10
	2019	10
	2020	1
RZHL	2018-2020	21
Gjithsej	2018	52
	2019	55
	2020	34

Figura 15: Paraqitja grafike e projekteve të udhëhequra nga gratë për tre(3) vite (2018-2020)




